



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 05.02.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 03.02.2020 të parashtruar nga Operatorit Ekonomik “PE-VLA-KU” sh.p.k.- Dega në Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i Qarkores – Tranziti i ri”, me Nr. të Prok: 632-19-2998-5-1-1 nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet si** e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik “PE-VLA-KU” sh.p.k.- Dega në Kosovë, e dt. 03.02.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Qarkores – Tranziti i ri”, me Nr. të Prok: 632-19-2998-5-1-1, kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, te AK –së, të datës 31.01.2020 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 31.01.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “PE-VLA-KU” sh.p.k.- Dega në Kosovë, me datë 03.02.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i Qarkores – Tranziti i ri”, me Nr. të Prok: 632-19-2998-5-1-1,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 05.02.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Për pretendimin tuaj se jeni shpallur administrativisht i përgjegjshëm, sqarojmë se kjo është bërë për shkak të një gabimi teknik të përvjedhur nga specifikacioni (është paraqitur dy herë certifikata EN 62031), i cili nuk është vërejtur as nga Komisioni i ri-vlerësimit e as nga zyrtarët e prokurimit.

Edhe po të ishit administrativisht i përgjegjshëm, prap nuk do të plotësonit kërkesat e Autoritetit kontraktues, sepse tenderi juaj është me çmim më të lartë.

Autoriteti Kontraktues pas rishikimit të dokumenteve, dhe duke u mbështetur në nenin 1 të LPP-së, qëllimi i të cilit është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të Autoriteteve Kontraktuese në Kosovë, dhe të nenit 6 të këtij ligji sipas të cilit Autoritetet Kontraktuese janë të obliguara që të sigurojë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, konstaton se Grupi i Operatorve Ekonomik Sh”**Drini Company” sh.p.k.** i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara në dosjen e tenderit dhe Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Tenderi juaj është i pasuksesshëm për arsye se nuk i plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues, sepse tenderi juaj është me çmim më të lartë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi të këtij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës